



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjenol/Prilbato Received/Delivery	12.08.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKURTAR	4693/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.639/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.639/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesit

të cilët me autorizim i përfaqëson Av. \_\_\_\_\_ nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.639/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesit

### A r s y e t i m

Ankuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ më datë 19.07.2022 përmes postës kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar më datë 21.07.2022 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.639/2022. Ankuesit pretendojnë të ju njohët e drejta e kompensimit të pagave jubilarë dhe shujtave ditore sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.07.2022 ka dërguar kërkesën për



përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa Këshilli më datë 29.07.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me Nr. Prot:4224/2022 të datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 21.04.2021; Vërtetimin për dërgesës i datës 01.07.2022; Kërkesën e datës 01.06.2022 nga ankuesin për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.07.2022; Akt Emërimit e datës 16.04.2014 për ankuesin Akt Emërimit e datës 16.12.2014 për ankuesen Akt Emërimit e datës 20.01.2015 për ankuesen Akt Emërimit 11.12.1019 për ankuesin Akt Emërimit e datës 16.04.2014 për ankuesen Vërtetimin e datës 27.07.2022 për ankuesit dhe Listën e pagave gusht 2017 për ankuesit; Vendimin me Nr. 168/2021 i datës 01.09.20121 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.639/2022 e datës 21.07.2022 është e palejuar, *sepse:*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave materiale, ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 16.04.2014 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Bazës së të Dhënave për Skemat Sociale, ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 20.01.2015 është e punësuar në Zyrtare e Lartë e Kontrollit, ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 11.12.2019 është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Hartimin e Politikave Sociale dhe ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 16.04.2014 është e punësuar në pozitën Zyrtar i Bazës së të Dhënave për Skemat Sociale të gjithë në ish-Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Të njëjtit më datë 01.07.2022 kanë parashtruar kërkesë pran organit të punësimit për kompensimin e pagës jubilarë dhe shujtave ditore mbi bazën e Kontratës së Përgjithshme Kolektive, ndërsa në mungesë të përgjigjes me shkrim nga organi i punësimit ankuesit me datë 19.07.2022 përmes postës kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, dhe rrjedhimisht duke marr parasysh konstatimin si me lartë se ankuesit me datë 01.07.2022 kanë parashtruar kërkesë pranë organit te punësimit, ndërsa për shkak të heshtjes*



administrative me datë 19.07.2022 përmes postës kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative - heshtja administrative, kështu që ankesa e ankuesve është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe neni 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.639/2022

Avdyll BEKTESHI

  
Procesmbajtës

  
Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT);
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MFPT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.